

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, si gjykatë civile e shkallë së parë, gjyqtari, N. K. , me bashkëpunëtorin profesional, Shahadin Destani, në kontestin e paditësit Z. Ç. nga Prizreni, rr. " " , nr. " kundër të paditurit A. S. , nga Prizreni, rr. " " , nr. " , për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 500 euro, me datën **08.10.2015**, mori këtë:

A K T G J Y K I M


I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Z. Ç. nga Prizreni, dhe **OBLIGOHET** i padituri A. S. , nga Prizreni, që paditësit Z. Ç. nga Prizreni, në emër të dëmit material të shkaktuar në bazë të veprës penale, t'ia kompensoj shumën prej 500,00 (pesëqind) euro, me kamatë ligjore, të cilën e aplikon bankat komerciale të Republikës së Kosovës, për mjetet e deponuara në afat prej një (1) viti, e cila kamatë do të llogaritet nga data 08.10.2015, e deri në pagimin përfundimtar të këtij borxhi, shumë kjo që do të paguhet brenda 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën ekzekutim të përmbarimit të ligjor.

II. OBLIGOHET i padituri që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj shumën prej 130 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën ekzekutim të përmbarimit të ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi Z. Ç. , nga Prizreni me dt. 22.11.2013, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit A. S. , nga Prizreni, përmes se cilës ka kërkuar kompensimin e dëmit material në shumën prej 500,00 euro, të shkaktuar në bazë të veprës penale të vjedhjes nga neni 252 par. 1 të KPK-së.

Në shqyrtimin kryesor paditësi ka deklaruar se ngelë në tërësi në të dhënët e cekura në padi duke sqaruar për faktin se pala e paditur me veprimet e tija, gjegjësisht me datë 02.05.2011 nga oborri i paditësit ka kryer vjedhjen e sasisë së dërrasave konkretisht 25m² dërrasa dhe 19 copë shtafne të cilat sende i ka vjedhur për qëllimet e tija personale me ç' rast paditësi i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 500 euro. Paditësi më tej ka shtuar se, pala e paditur për këto veprime është shpallur fajtor me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.92/2012 i datës 03.09.2013, andaj nga këto arsye ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia dhe i padituri të obligohet që në emër të kompensimit të dëmit për vjedhjen e këtyre dërrasave të paguaj shumën prej 500 euro që është vlerë reale e dëmit të shkaktuar me rastin e marrjes së këtyre dërrasave. Po ashtu i njëjti ka kërkuar edhe shpenzimet e kësaj procedure dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 100 euro, për taksën gjyqësore shumën prej 15 euro si dhe shumën prej 15 euro për vendimin e gjykatës, gjithsej shumën prej 130 euro.



I padituri A. S. edhe pse nga gjykata është ftuar në mënyrë të rregullt i cili fakt është vërtetuar nga shikimi i fletëdergesave paraprake dhe asaj të shqyrtimit kryesor të datës 07.09.2015, i njëjti ka refuzuar të njëjtat e po ashtu nuk ka prezantuar në shqyrtimin kryesor si dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar. Andaj gjykata me aplikimin e dispozitave ligjore të parapara me nenin 423.4 të LPK-së, ka vendosur që shqyrtimin e datës 08.10.2015 ta mbaj në mungesë të palës së paditur.

Gjykata më qëllim të konstatimit dhe vërtetimit të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike ka administruar këto prova: ka bërë leximin e aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.92/2012 i datës 03.09.2013.


Me vlerësimin e gjithanshëm të të gjitha provave të administruara, fakteve të vërtetuara, veçmas secilën si dhe në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se, kërkesëpadia e paditësit është e **bazuar**.

Me leximin e aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.92/2012 i datës 03.09.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri A. S. nga Prizreni, është shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes nga neni 252 par.1 të KPK-së dhe i është shqiptuar dënimi me kusht në kohëzgjatje prej 6 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2 (dy) viteve nëse i gjykuari nuk kryen veprë të re penale, për arsyen se i njëjti me datë 02.05.2011 në oborrin e të dëmtuarit tani paditësit Z. Ç., shfrytëzon rrethanat dhe momentin e volitshëm dhe nga ballkoni i shtëpisë së tij i tërheq 25m² dërrasa dhe 19 copë shtafne, me të cilat i shkakton dëm material paditësit në shumën prej 500 euro.

Me nenin 154 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se **“Kush shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”**. Në bazë të këtij principi pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe pakujdesia. Çështja e përgjegjësisë subjektive është e rregulluar në bazë të nenit 140 të LMD-së. Në rastin konkreti padituri nuk ka ofruar prova gjykatës që do të provonin se dëmi ndaj paditësit është shkaktuar pa fajin e tij.

Meqenëse i padituri nuk ka dorëzuar në gjykatë përgjigje në padi dhe nuk ka marr pjesë në asnjë shqyrtim gjyqësor, përkundër thirrjes me rregull dhe si rrjedhojë nuk ka ofruar prova që do të kundërshtonin pretendimet e paditësit, gjykatës i rezultoi si e provuar se i padituri ka shkaktuar dëmin dhe nuk i ka kryer obligimet ndaj paditësit, të cilat janë cekur më lartë.

Andaj në bazë të rrethanave të cekura më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pra nga të gjitha këto fakte është provuar dhe është vërtetuar se shkaktar për këtë dëm material është i padituri dhe atë, në bazë të veprës penale të vjedhjes nga neni 252 par. 1 të KPK-së, i cili fakt është vërtetuar edhe me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren, dhe nga këto arsye Gjykata morri këtë qëndrim duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.



Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së e të cilat kanë të bëjnë, për përpilimin e padisë shumë prej 100 euro, për taksën gjyqësore shumë prej 15 euro si dhe shumë prej 15 euro për vendimin e gjykatës.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
C.nr.1129/13, datë 08.10.2015

Bashkëpunëtori profesional,
Shahadin Destani



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate.